


**Shkodër**  
**Tiranë**  
**Elbasan**  
**Berat**  
**Fier**



## PËRMBAJTJE

1. Përmbledhje
2. Hyrje
3. Regjistrimi i Kandidatëve nga Minoriteti Rom dhe Egjiptian në Partitë Politike
4. Vëzhgimi i Zgjedhjeve
5. Pjesmarrja e votuesëve të Minoritetit Rom dhe Egjiptian gjatë fushatës dhe në votime
6. Rekomandime

## 1. Përmbledhje

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon të drejta të plota politike, civile dhe sociale për personat që u përkasin pakicave kombëtare.

Ligji për “Mbrotjtjen e Pakicave Kombëtare” nr 96/2017 njohu zyrtarisht nëntë pakica kombëtare (Grek, Maqedonas, Arumun, Rom, Egjiptian, Malazez, Boshnjake, Serb dhe Bullgar). Regjistrimi i vitit 2011 renditi më pak se 1.5% të popullatës, si pjesë të një pakice kombëtare; megjithatë, kjo shifër konsiderohet e pasaktë.

Në çdo zgjedhje vendore dhe parlamentare, Institucioni i Komisionit Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ) ka detyrimin të informojë dhe të edukojë popullatën, në këtë rast minoritetet në gjuhën e tyre për procesin elektoral, edukimi konsiston sesi qytetarët duhet të votojnë, rëndësia e votës dhe procesi i pjesmarrjes.

KQZ<sup>1</sup>, me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare, organizoi takime me përfaqësues të minoriteteve Rom dhe Egjiptiane si dhe me banor në disa qytete kryesore ku ka një popullsi të konsiderueshme të minoritetit Rom dhe Egjiptian

Përgjatë 3 muajve KQZ<sup>2</sup> prodhoi spote për rrjete sociale dhe televizione ku përdorej gjuha rome si dhe spote për billborde në disa stacione autobuzi në Tiranë, por jo në qytete të tjera.

Pjesmarrja e votuesëve Rom dhe Egjiptian në zgjedhjet vendore të 14 Maj-it 2023 vetëm në 5 bashki (Tiranë, Shkodër, Elbasan, Fier dhe Berat ) ishte **1576** votues.

---

<sup>1</sup> <https://www.youtube.com/ëatch?v=rURJ54HUINs>

<sup>2</sup> [https://www.youtube.com/ëatch?v=5EAYZ3U\\_S\\_o](https://www.youtube.com/ëatch?v=5EAYZ3U_S_o)

## 2. Hyrje

Community Reporters Albania është organizatë mediatike jo-fitimprurëse e regjistruar në muajin Tetor 2020 me nr vendimi 1537, në fokusin e saj ka raportimin multimedial në media të shtresave në nevojë për të kërkuar të drejtat e tyre sociale, ligjore dhe për ti fuqizuar ata në media.

Gjatë muajit Prill 2023, qendra kontraktoi 10 të rinj nga minoriteti Rom dhe Egjiptian për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe përdorimin e teknologjive të reja për raportimin gazetaresk. Duke u nisur nga vëzhgimet e kryera në zgjedhjet e kaluara nga OSCE/ODIHR për pjesmarrjen e pakicave kombëtare në procesin e votimit, kanë deklaruar që vota e antarëve të minoritetit Rom dhe minoritetit Egjiptian është intimiduar, blerë, shitur dhe vota e tyre nuk ka qenë e lirë.

Ky është [vëzhgimi i dytë](#)<sup>3</sup> që është kryer nga vëzhgues Rom dhe Egjiptian në Shqipëri, për qëllimin që vota e minoriteteve të jetë e rëndësishme edhe e mbrojtur dhe të vëzhgohet pasi në të gjithë zgjedhjet e kaluara, raportet tregojnë së vota e tyre është pre e intimidimit, shit-blerjes.

Vëzhgimi u krye vetëm në 5 bashki ku konsiderohet si popullsia më e madhe e minoritetit Rom dhe Egjiptian, konkretisht në **Tiranë** (Njësia Administrative nr 1, 5 ,6) **Berat** (Lagjia “Donika Kastrioti, Shkolla “Shyqyri Lakra”, Shkolla “Kristo Isak” dhe Qendrat Komunitare) **Elbasan**( 5 Maj ose Rrapishtë, Lagja “Beqir Dardha dhe Kopshti Publik Nr 12) **Fier** (Baltez) dhe **Shkodër** (Lagja Iliria)

---

<sup>3</sup> <https://reportersalbania.com/raporti-i-vezhgimit-te-zgjedhjeve-te-25-prillit-per-romet-dhe-egjiptianet/>

### 3. Regjistrimi i Kandidatëve për këshilla bashkiak nga Minoriteti Rom dhe Egjiptian në Partitë Politike dhe programet politike të partive në Shqipëri

Regjistrimi i kandidatëve dhe partive ishte gjithëpërfshirës. KQZ-ja regjistroi 21 parti politike dhe 1 koalicion për të garuar në të gjithë vendin.

Në zgjedhjet vendore të 14 Maj 2023, nga minoriteti Rom dhe Egjiptian morën pjesë 10 kandidatë për këshilla bashkiak me parti: Partia Socialiste e Shqipërisë, Koalicioni Bashkë Fitojmë dhe Nisma Thurje.

Nr	Emer Mbiemer	Partia	Renditja	Bashkia
1	Fatmira Dajlani	Partia Socialiste	14	Krujë
2	Fatmir Kasemi	Partia Socialiste	19	Roskovec
3	Luan Shano	Partia Socialiste	19	Devoll
4	Sebastjan Hamzaj	Koalicioni Bashkë Fitojmë	23	Lushnje
5	Ferit Milanj	Partia Socialiste	28	Lushnje
6	Rozina Kormuzi	Partia Socialiste	37	Vlorë
7	Raxhi Rakipi	Partia Socialiste	38	Elbasan
8	Saimir Kazanxhiu	Partia Socialiste	31	Fier
9	Sead Kazanxhiu	Partia Socialiste	38	Tiranë
10	Erjola Struga	Nisma Thurje	2	Korçë

#### 4. Vëzhgimi i Zgjedhjeve

Community Reporters Albania, raportoi për procesin e votimeve për 5 bashki të vendit ku sipas vëzhguesëve pjesmarrja e votuesëve Rom dhe Egjiptian është rreth **1576 votues**.

Nga vëzhgimet që u kryen në terren dhe në qendra votimi sipas vëzhguesëve kemi këto rezultate si më poshtë:

Në qytetin e Tiranës, në Njësitë Administrative 1,5 dhe 6 rezultojnë se:

- Romët dhe Egjiptianët kanë qenë pjesërisht të informuar për procesin zgjedhor por jo rregullat për të votuar.
- Persona të ndryshëm kanë shoqëruar pjestarë të minoritetit rom dhe egjiptian për të votuar sipas preferencave të personave të ndryshëm.
- Romët dhe Egjiptianët kanë pasur ndihmë për të votuar.
- Jashtë ambienteve të qendrave të votimit, persona të ndryshëm kanë ndikuar dhe biseduar me anëtarët e minoritetit Rom dhe Egjiptian.
- Gjatë fushatës elektorale persona të ndryshëm kanë paketa ushqimore dhe para cash për të ndikuar tek votuesit.
- Romët dhe Egjiptianët kanë hasur problematika për të gjetur qendrën e votimit dhe vështirësi për të votuar.

Në qytetin e Elbasanit në Lagja “5 Maj” dhe Lagja “Beqir Dardha” dhe Kopshti Publik Nr 12 rezultojnë se:

- Romët dhe Egjiptianët kanë votuar në grupe dhe familjarisht.
- Romët, Egjiptianët janë shoqëruar nga persona të tjerë për në qendrën e votimit
- Janë orientuar drejt qendrave të votimit nga persona pa “bagde”

Në qytetin e Fierit, në fshatrat Levan, Drizë, Baltëz dhe Mbrostar rezultojnë se:

- Në disa raste votuesit Rom kanë kërkuar ndihmë për t'i shoqëruar të votojnë.
- Romët janë shoqëruar nga persona të tjerë për të votuar në qendrën e votimit.

Në qytetin e Beratit në Lagjen “Donika Kastrioti, Shkolla “Shyqyri Lakra”, Shkolla “Kristo Isak” dhe Qendrat Komunitare

- Janë ndihmuar për të votuar nga të tjerët pasi nuk dinin të votonin

Në qytetin e Shkodrës, në lagjen Iliria

- Votime në grup
- Të moshuarit janë ndihmuar nga familjar të tyre për të votuar

Sipas vëzhguesëve problematikat mbeten po të njëjta, ku romët dhe egjiptianët i shoqërojnë tek qendra e votimit dhe i udhëzojnë se ku duhet të votojnë, po ashtu votuesit kanë deklaruar se **vota e tyre është shitur**, dhe janë ndikuar nga persona të tjerë nga partitë politike.

Sipas vëzhguesëve, në qytetin e Tiranës, shumica e Romëve dhe Egjiptianëve kanë qenë të pa orientuar dhe kërkonin ndihmë për të gjetur emrat dhe qendrën e votimit. Sipas tyre janë disa persona pa “bagde” i kanë shoqëruar dhe i kanë orientuar se ku duhet të votojnë, raportohet se edhe në qendra të tjera të votimit ka pasur persona pa “bagde” të cilët kanë pritur romët dhe egjiptianët në qendrat e votimit për t’i orientuar për votën e tyre.

Raportohet nga vëzhguesit që banorë rom kanë pasur ndihmë nga shoqëruesit pa “bagde” për të votuar në kutinë e fshehtë, gjithashtu vërehet se në qendrën e votimit ka pasur njerëz të cilët janë ofruar të ndihmojë romët që nuk dinë të lexojnë.

## 5. Pjesmarrja e votuesëve Rom dhe Egjiptian gjatë fushatës elektorale dhe zgjedhjeve

Studime të shumta nga organizata ndërkombëtare kanë dëshmuar se niveli arsimor i minoritetit Rom është i ulët, dhe si rrjedhojë në 5 bashkitë që janë vëzhguar, banorë të ndryshëm kanë deklakuar se kanë pasur probleme me leximin dhe kuptimin e fletës së votimit.

Vëzhgimi u krye në 5 Bashki (Tiranë në tre Njësi Administrative 1, , 5, 6) (Berat në Donika Kastrioti, Shkolla “Shyqyri Lakra”, Shkolla “Kristo Isak” dhe Qendrat Komunitare) (Fier në fshatin Baltëz), (Elbasan në lagjen 5 Maj dhe Lagja “Beqir Dardha” dhe Kopshti publik 12) dhe (Shkodra në lagjen Iliria )

Tiranë	420 Rom dhe Egjiptian në 3 Njësi Administrative (1, 5, 6)
Fier	153 Rom në Fshatin: Baltëz
Elbasan	120 Rom dhe Egjiptian
Shkodër	493 Rom dhe Egjiptian
Berat	390 Rom dhe Egjiptian

## 6. Rekomandime

- a. Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve(KQZ) duhet të edukojë popullsinë Rome në vende lokale ku informacioni është i cunguar të cilët informojnë dhe orientojnë votuesit për zgjedhjet.
- b. KQZ-ja duhet të punësojë gjatë fushatës qytetarë që i përkasin minoritetit Rom dhe Egjiptian të qëndrojnë gjatë ditës së votimit për t'i ndihmuar të gjejnë emrat në listë dhe orientimin në qendrat e votimit.
- c. KQZ-ja duhet të angazhohet më shumë pa pasur nevojë për projekte ndërkombëtare për të trajnuar qytetarë nga minoriteti Rom dhe Egjiptian për të qenë informues në komunitet gjatë fushatës zgjedhore.
- d. KQZ-ja duhet të sigurojë që vota e minoriteteve të jetë e mbrojtur duke ngrejtur mekanizma mbrojtësë në komunitet dhe në qendra votimi për këto grupe vulnerabël si dhe të punësojë gjatë fushatës zgjedhore persona nga minoriteti Rom dhe Egjiptian në rolin e anëtarëve të komisionit jo.
- e. KQZ-ja duhet të përkthejë materialet informuese dhe fletën e votimit gjatë ditës së votimit në gjuhën e minoritetit Rom, aty ku ka një popullsi të konsiderueshme.
- f. Institucioni i Policisë së Shtetit duhet të garantojë që votuesit Rom dhe Egjiptian të votojnë të lirë, të pacënuar dhe të paintimiduar
- g. Partitë politike duhet që gjatë fushatës të edukojmë popullsinë rome dhe egjiptiane rregullat e votimit në qendrat e votimit
- h. Partitë politike duhet të kenë njerëz të cilët ndihmojnë dhe orientojnë qytetarët për gjetjen e emrit dhe qëndren e votimit.



